



## DAP DHE QZHF ORGANIZUAN NJË PUNË TRE DITORE NË SHKUP – “SI NDIKOJNË PROCESET E MENAXHIMIT TË RREZIKUT PËR PAJTUESHMËRINË LIDHUR MBI MORALIN TATIMOR”

Në Shkup, në periudhën prej 17 deri më 19 Tetor 2023, u mbajt punëtorja me temë “Si ndikojnë proceset e menaxhimit të rrezikut të pajtueshmërisë në moralin tatimor”.

Punëtorinë e organizoi Drejtoria e të ardhurave publike dhe Organizata ndërkombëtare "Qendra për zhvillimin e financave" - QZHF, me seli në Lubjanë, Slloveni.

Manifestimin e hapën drejtoresha e DAP-it, Sanja Lukarevska dhe drejtoresha e QZHF-së, Jana Repanshek.

Drejtoresha e DAP-it, Sanja Lukarevska sqaroi se në Drejtorinë e të ardhurave publike përdoren mjete për identifikimin e tatimpaguesve për përmbushje me kohë, vullnetare të obligimeve, lehtësimin e procedurave për regjistrim, llogaritje, raportim dhe pagesë të tatimeve dhe theksoi se përmes bashkëpunimit me organizata dhe mbështetës të tjerë ndërkombëtarë, përmes projekteve dhe trajnimeve, përmirësohen jo vetëm proceset, por edhe kapacitetet e administratës tatimore dhe zbatohen masa që do të kontribuojnë në rritjen e moralit tatimor, qëllimi është mbledhja e drejtë dhe efikase, të taksave dhe tarifave të tjera publike me një shkallë të lartë të përputhshmërisë vullnetare.

Drejtoresha e QZHF-së, Jana Repanshek, e cila u drejtua online, falënderoi drejtoreshën Lukarevska për organizimin e ngjarjes dhe theksoi se ngjarjet e tilla mundësojnë rrjetëzimin e administratave tatimore, dhe shpërndarjen e njohurive, praktikave dhe përvojat më të mira përmes QZHF-së është çelësi për përparimin e administratave tatimore.

Punëtorja dha një rishikim të taksave në një këndvështrim tjetër. Në vend të ligjeve tatimore, procedurave, afateve dhe deklaratave tatimore, temë diskutimi ishte ajo që ndikon në vlerat, besimet dhe perceptimet shoqërore që çojnë në ndërtimin e qëndrimit dhe sjelljes së individit sipas parimit të solidaritetit dhe pagesës së ndershme dhe të përgjegjshme të taksave. Pjesëmarrësit e punëtorisë u njohën gjithashtu me tendencat globale dhe rajonale të moralit tatimor, faktorët socio-ekonomikë dhe institucionalë si dhe me kultivimin e kulturës së pajtueshmërisë. Përfaqësues nga Drejtoria e të ardhurave publike, si nikoqirë të eventit, shpjeguan se si Drejtoria e të ardhurave publike kontribuon në ndërtimin e besimit ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve, si dhe aktivitetet dhe instrumentet e ndërmarra nga institucioni për rritjen e moralit tatimor dhe ndërgjegjësimin tatimor.

Në puntorinë treditore, vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të qasjeve të menaxhimit të rrezikut për pajtueshmërinë, mjeteve që duhet të zgjidhen në situata të caktuara dhe përmes proceseve të përmirësuara për të siguruar shërbime të shpejta dhe cilësore dhe transparencë më të madhe, dhe pjesëmarrësit nga Mali i Zi, Shqipëria, Kosova, Republika e Serbisë, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Moldavia, Armenia, Holanda, Suedia, Mongolia, OBZHE dhe përfaqësues nga Drejtoria e të ardhurave publike që ndanë përvojat e tyre, u dakorduan se vizioni i të gjitha administratave tatimore është krijimi i një shoqërie ku secili të paguajë pjesën e duhur.